Emri (emri i prindit) mbiemri	Numri personal	Numri i njësisë kadastrale	Nënshkrimi
KK Skenderaj	%	1076-3	


Nënshkrimi dhe vula e gjeodetit:

Gani Halilaj

Data: 8.09.2020

Gjeodeti: Gani Halilaj Numri i licencës: %
Adresa: 18 Nendori

Av. Shefqet Ibrahim
rr. "18 Qershori"
Tel 044/192-471
Skenderaj



KOMUNA SKENDERAJ

KREDITORI: Islam Hoxha nga fshati Runik, komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson Av. Shefqet Ibrahim nga Skenderaj

DEBITORI: Komuna Skenderaj-Drjectoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë për Zyren e Kryetarit

Në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Skenderaj, C nr.253/2010 të dt.05.09.2016, i cili është vërtetua me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr.238/2017 të datës 05.09.2020 me të cilin është detyruar debitori që kreditorit në emër të kompensimit tokën e marrë në sipërfaqe prej 337 m2 ti paguaj shumën prej 25.275,00 €, në emër të trungjeve të dëmtuara të drunjëve dekorativ (pishave) shumën prej 1.400,00 € dhe në emër të ndërtimit të murit mbrojtës shumën prej 15.359,40 € si dhe në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 1.411,00 €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërçimin e përmbartimit të detyrueshëm. Aktgjykimi ka marrë formën e prerë edhe është i ekzekutueshëm.

PROVË:

Aktgjykimet-original të vërtetuar me vulat e formës së prerë dhe i përmbartueshmërisë.

Debitori nuk ka përmbushë obligimin e caktuar në afatin parativ ndaj kreditorit jashtë procedurës përmbartimore, prandaj me qëllim të ikjes së shpenzimeve të panevojshme në procedurën e përmbartimit paraqes këtë

PROPOZIM PËR ~~PËRMBARTIM~~ NDËRRIMIN E PASURISË

1. Që ju si debitor të përmbartoni këtë aktgjykim ashtu që me qëllim të rregullimit të gjendjes që kemi me paluajtshmeri kur e di se edhe unë mbaj një pjesë të pasurisë së komunës, ndërsa ju me kenë marrë pasuri timen ashtu që propozoi që të bëjnë kompensimin me sipërfaqe të njëjtat dhe ndryshimi të paguhet me çmim të cilin e cakton Asambleja Komunale apo komisioni përkatës komunal.
2. Që të paguani shumën prej 15.359,40 € për ndërtimin e murit mbrojtës në llogarinë e të autorizuarit tim të hapur në BPB nr. 1305001001539679.
3. Që të paguani shumën prej 1.400,00 € në emër të dëmtimit të drunjëve dekorativ në llogarinë e të autorizuarit tim të hapur në BPB nr. 1305001001539679
4. Që të paguani shumën prej 1.411,00 në emër të shpenzimeve qenësore në llogarinë e të autorizuarit tim të hapur në BPB nr. 1305001001539679

SHPENZIMET:

Për Përpilimin e propozimit shumën prej 312,00 €

AVKAT
SHEFQET IBRAHIMI
Rr. "18 Qershori"
Tel: 044/192-471
Skenderaj
Kreditorin:
Av. Shefqet Ibrahim

Av. Shëfqet Ibrahim
rr. "18 Qershori"
tel. 045 41 11 491

SHEFQET IBRAHIMI
rr. "18 Qershori"
tel. 045 41 11 491
SKENDERAJ

AUTORIZIM

Me të cilin e autorizoi avokatin Shëfqet Ibrahim nga Skenderaj, rr. "18 Qershori" i cili posedon librezë të Avokatit nr. 606/1998 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, që të me përfaqësoi, në Prokurori, në Gjykata në procedurën penale, civile, jashtë-kontestimore, përmbartimore, kundërvajtësi, në procedurën pranë gjykatave Ekonomike, dhe ato Administrative, sikurse dhe në procedurën administrative, e posaçërisht e autorizoi me Debitorin Komuna Skenderaj të arrij marrëveshje për përmbushjen e Aktgjykmimit C.nr.253/2010 në mënyrën e arritjes së marrëveshjes për ndërrim të paluajtshmerisë, përkatësisht të dhënies së pronës aq sa ka marrë dhe të kompensohet pjesa që është më tepër, si dhe në rast të mos arritjes së marrëveshjes të ushtroi propozimin për përmbartim në të përmbartuesi sipas zgjedhjes së tij

I njëjti mund të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike dhe ti përdorë të gjitha mjetet juridike, të ushtroi padi dhe parashtrës tjerë, të lidhë ujdi, të jap deklarata trashëgimore, të ushtroi ankesa, dhe mjete tjera juridike, si të rregullta ashtu edhe të jashtëzakonshme, si dhe ti ndërmarrë të gjitha punët juridike të cilat janë në interesin tim.

- Veçanërisht si të autorizuar timin e autorizoi që në raste të caktuara të paguaj taksa, si dhe t'i bartë mjetet në llogarinë e tij, të hapur në Bankën për Biznes nr.1305001001539679

I autorizuari ka të drejtë që sipas nevojë gjatë procedurës të angazhoi edhe avokat tjetër i cili do të zëvendësonte në ndonjë veprim procedural.

Autorizuesi
Islam Hoxha
f. Runik Skenderaj

Islam Hoxha

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Cur. 253/ 2010

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NE SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, si civile në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, me sekretarin juridik Shaqir Hetemi në kontestin e paditësit Islam Hoxha nga fshati Runik, që e përfaqëson me autorizim Shefqet Ibrahim avokat në Skenderaj, kundër të paditurës komuna në Skenderaj që e përfaqëson me autorizim Fatos Sejdiq avokat publik komunal në qështjen juridike për kompenzim dëmi, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës kryesore me dt. 05.09.2016, me pjesmarrjen e palëve ndërgjyqëse, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar padija dhe kërkespadija e paditësit Islam Hoxha nga Runiku.

DETYROHET e paditura Komuna Skenderaj që paditësit t'i kompenzoj dëmin material të shkaktuar me ndërtimin e rrugës Turiqec- Runik në pjesën e parcelës katastrale 1269-1 që i është marrë sipërfaqja e tokës prej 337 m², në ZK në Runik shumën prej 25.275,00 €, për dëmin në 100 trungje të drujve dekorativ (Pisha) të dëmtuara në këtë parcel shumën prej 1400 €, për ndërtim të murit mbrojtës për evitimine shëmbjes së parcelës së mbetur , në shumën e prej 15.359.40 €.

Gjithësejt në shumën e përgjthshme prej 42.034.40 € (dyzet e dymij e tridhjet e kater euro), si dhe shpënzimet e procedurës kontestimore dhe atë 79 € për hartim të padisë , 106,00 € taks për padi , për aktgjykim shumën prej 50 €, për tri ekspertiza 450 €, për përfaqësime të avokatit shumën prej 726 €, të gjitha këto shuma të lartëshenuara duhet të paguhën në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi Islam Hoxha përmes përfaqësuesit Shefqet Ibrahim avokat në Skenderaj me padinë e ushtruar në gjykatë me dt. 05.09.2008, ka kërkuar që të detyrohet e paditura komuna – Skenderaj t'i kompenzoj dëmin material për shkak se me rastin e ndërtimit të rrugës Turiqec- Runik ju ka marr një pjesë e truallit në Runik dhe nuk është kompenzuar prona , i është shkaktuar dëmi në druajt dekorativ që ishin të mbjellur në parcel, dhe nuk është ndërtuar muri mbrojtës për sigurimin e parces së mbetur nga shembja që i kanoset , i propozoj gjykatës nxjerrjen e provave përmes ekspertizës së gjeodozisë për identifikimin , matjen e parcelës , ekspertizën e agronomisë për caktimin e çmimit të tokës dhe të dëmit në druajt dekorativ dhe të ndërtimit për llogaritjen e çmimit kushtues për ndërtim të murit mbrojtës.

Pas nxirrjes së ekspertizave e precizoj padin dhe kërkesëpadin ashtu që kërkoj nga gjykta që e paditura të detyrohet t'i kompenzoj dëmin në shumën prej 42.434,00 €. I kërkoj shpënzimet e procedurës për ekspertiza shumën prej 450,00 €, për hartim të padisë 70,00 €, për taksën për padi si dhe për përfaqësimet e avokatit në bazë të TOA.

E paditura përmes përgjegjës në padi e kundërshtoj padinë si të pa bazuar me pretendimin se komuna nuk udhëheqet në emrin e paditësit dhe nga kjo bazë nuk i takon e drejta e kompenzimit si dhe nuk ka shterrur të gjitha mjetet juridik në procedurën administrative për realizimin e të drejtës së pretenduar.



Pas nxirrjes së ekspertizave të gjeodezisë, agronomisë dhe të ndërtimit, i kundërshtoj të gjitha si për nga baza ashtu edhe nga lartësija. I propozoj gjykatës që padija e paditësit të refuzohet si e pa bazur.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në qështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 8 të LPK në seancën kryesore me dt. 05.09.2016, i nxori dhe i administroj të gjitha provat e shënuara në procesverbalin e kësaj seance, një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njëri-njëri nga të cilat rezulton se kërkespadija e paditësit është e bazuar.

Në bazë të kontratës të lidhur në Gjykatën Komunale në Skenderaj me dt. 02.03.2010 në mes të paditësit Islam Hasan Hoxhaj si blerës dhe Vukomir Staleta Llazoviq nga Runiku e vërtetuar nën nr. 244/2010, nga e cila vërtetohet se paditësi nga një punë vlefshme juridike kishte fituar të drejtën e pronësisë në pronën e palujtshme lëndore parcela katstrale P- 72015062-01269-1 me kulturë Bujqësore në vendin e quajtur "Miftaraj – të Shtëpia" në sipërfaqe prej 475. m2 pronë të cilën e ka regjistruar në emrin e tij në Regjistrin për palujtshmeri UL-72015062-00473.

Në dispozitat e nenit 36 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore është përcaktuar se "Për bartjen e pronës në palujtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në regjistrin e të drejtave në palujtshmeri".

Sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit të gjeodezisë Bedri Gashi të cili gjykata i dha bindje të plotë si provë e besueshme është vërtetuar se parcela katstrale nr. 1261-1 ka formë të trekëndëshit gjindet në zonën katastrale në "Runik", e cila kufizohet në anën veri- lindore dhe veri perendimore me rrugën Magjistrale Mitrovicë- Pejë, ndërsa në pjesën veri- perendimore dhe jug- perendimore me rrugën Runik – Kosterc. Parcela katastrale është me kulturë "kullësë", pjesa e mbetur është e mbjellur me drunjtë dekorativ pisha.

Kjo parcelë në pjesën veri- lindore dhe veri- perendimore kufizohet me parcelen nr.2051-0 nga pika 1,2,3 dhe 4 rrugë publike me një gjatësi prej 33.84 m, e cila pjesë është objekt i kontestit në mes të ndërgjyqësve.

Pas analizimit të gjitha provave shkresore, pjesës grafike, skicës nga vendi, ortofotos dhe fotografive nga vendi rezulton se parcela katastrale lëndore nr. 1269-1 kishte sipërfaqe prej 475.0 m2 nëpër të cilën është ndërtuar rrugë e asfaltuar në gjërsi prej 5.5 m në gjatësi prej 33.84 m. Kjo rrugë në gjatësinë e sipërshënuar ka skarpatën (pjesën e pjerrtë) nga pika 4 dhe 5 që ka lartësinë afro 2.5 m ndërsa në pjesën fundore nga pika 1 në drejtim të pikës së 6 ka lartësinë prej 5.50 m dhe një këndë pjerrtësie afro 42. shkallë.

Nga kjo gjëndje faktike rezulton se paditësit nga parcela katstrale nr. 1269-1 me rastin e ndërtimit të rrugës Turçevec – Runik i është marrë sipërfaqja prej 337 m2 ndërsa ka mbetur sipërfaqja prej 138.0 m2.

Pasi që prej ekspertizës së gjeometrit pa mëdyshje është vërtetuar se paditësit i është marrë sipërfaqja e pronës së palujtshme si është konstatuar më lartë, gjykata e ka nxjerr provën për konstatimin e lartësisë së çmimit të tokës.

Sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit të Agronomisë Inxh. Hajrullah Muli paditësit i është marrë sipërfaqja e pronës së palujtshme prej 337.0 m2 dhe ka mbetur sipërfaqja prej 138.0 m2 e cila nuk mundet të shfrytëzohet për ndërtim të shtëpisë apo veprimtari biznesi. Pjesa e mbetur për shkak të pjerrtësisë ka filluar të rëshqet dhe do të pësojë humbje të vlerës.

Duke marrë për bazë të gjitha faktet, si vendin ku ndodhet në Runik, pozitën në trekëndëshin në mes të dy rrugëve, kulturën "Bujqësore" dhe pas marrjes së mendimeve edhe nga fqinjë sa i përket çmimeve aktuale në afërsi të pronës ka ardhë në përfundim se metri katrorë në këtë vendë ka çmimin real prej 75 € për metër katrorë e llogaritur me sipërfaqën prej 337 m2 arrin në shumën prej 25 277.50 €.



Eksperti ka vlerësuar se në parcelën katastrale kan qenë të mbjellur druj dekorativ të llojeve "Smarakt", "Argjenta", "Lejlan", dhe "Aura" dhe me rastin e ndërtimit të rrugës janë dëmtuar 100 trungje. Ky fakt është konstatuar në bazë të fotove nga vendi ku shifet parcela e mbetur me drunjë dekorativ dhe drujt tjerë të dëmtuar nga punimet gjatë ndërtimit të rrugës. Për çmimin kushitues të demit në druj ekspertit është bazuar në oferta e siguruar të NTP "Gjelbrimi" me dt. 22.03.2016, "NTP" Palma me dt. 21.03.2016 dhe NTP "Liridoni" me dt. 21.03.2016 dhe bazuar në këto fakte caktoj shumën prej 1400 €. €.

Gjykata e vlerësoj ekspertizën e agronomit të cilës i dha bindje të plotë për faktin se eksperti në mënyrë të drejtë dhe objektive pas analizimit të gjitha fakteve që janë përcaktues real të çmimin ka ardhë në përfundim për shumën që duhet të i kompenzohet paditësit për tokën e marrë dhe për drunjët dekorativ që i janë dëmtuar tërësisht me rastin e ndërtimit të rrugës.


Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar nga ekspertiza e gjeodolisë është konstatuar se paditësit e paditura në mënyrë arbitrare i ka marrë pjesën e parcelës katastrale nr. 1261-1 në sipërfaqe prej 337 m² pa i përfillur fare procedurën administrative të shpronësimit të përcaktuar në mënyrë decitive me Ligjin e Shpronësimit.

Me këtë veprim e paditura i ka cenuar dispozitat e nenit nenin 46 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku është përcaktuar "E drejta e pronës është e garantuar". Në paragrafin 3 të po këtij neni thuhet "Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nese ky ekspropriim është i autorizuar me ligj...". Në rastin konkret pa mëdyshje është vërtetuar se paditësit si pronar i ligjshëm i pronës lëndore në mënyrë arbitrare i është marr një pjesë e palujtshmeri dhe mbi këtë bazë ti takon e drejta e kompenzimit të pronës.

Sipas dispozitave të nenit 155 të LMD Gz. 29, i vitit 1978 dëmi përkufizohet si pakësim i mjeteve shoqërore respektivisht i pasurisë së dikuaj. Në rastin konkret paditësit me aktin dëmtues nga e paditura i është zvogëluar pasuria e palujtshme sipërfaqja e parcelës kadastrale nr.1261-1 nga sipërfaqja prej 475.0m² m² në sipërfaqja vetem prej 138.0 m². Është parim i përgjithshëm i përcaktuar në dispozitat e nenit 154 të LMD "Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë t'ia kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij".

Nga fakti i vërtetuar përmes ekspertizës të gjeodolisë se në anën veri- perendimore dhe jug-perendimore parcela kufizohet me parcelen katstrale nr. 2051-0 nga pika 1,2,3 dhe 4 rruga publike në gjatësin prej 33.84 m. në anën e majtë ku është hapur një kanal në këtë gjatësi për ujrë atmosferike dhe ka pjesën e pjerrt nga pika 4 dhe 5 në lartësi afro 2.5 m ndërsa nga pjesa fundore nga pika 1 në drejtim të pikës 6 ka lartësin prej 5.50 m me këndë të pjerrtësis prej 42 shkallë, dhe pjesa e mbetur e parcelës rrezikohet të shembet pa ndërtimin e një muri mbrojtës. Në propozimin e palës paditëse është nxjerr prova përmes ekspertit të ndërtimit Inxh Bajram Mustaf i cili pas daljes në vendë dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës ka ardhë në përfundim se : Sipërfaqja e mbetur e parcelës prej 138.00 m përgjatë rrugës Runik - Kostërc nga ana veri- prendimore dhe jug- përendimore ka një disnivel prej nivelit të rrugës dhe kuotës së terenit të ngastres së mbetur mesatarisht në lartësin prej 5.00 m, pasi që në këtë pjesë nuk është ndërtuar muri mbrojtës ka rrëshqitje të dheut si është konstatuar në pikat (F1,F2,F3,F4, e F6) për këto arsye jam i mendimit që patjeter duhet të ndërtohet muri mbrojtës për mbrojtjen e parceles nga shembja në rrugën Runik- Kostërc. Sipas ekspertit nese nuk ndërtohet muri mbrojtës dita ditës do të shembet dhe mund të vijë deri të zhdukja e tër sipërfaqes së truallit.

Eksperti ka konstatuar se për ndërtimin e murit mbrojtës duke filluar me " Rrmihjen dhe bartjen e dheut në largësi prej 5 km për murin dhe bazamentin e tij kushton 638.40€, për furnizimin me material dhe betonimin e bazamentit të murit mbrojtës me beton të shtypur MB 20 në shumën prej 1.824.00 €, për furnizimin me material dhe betonimin të murit mbrojtës me beton të shtypur MB 25 , shuma prej 11.400.49, për mbushjen me material të kombinuar në mes të ngastres dhe sipërfaqes së murit me ngjeshje shumën prej 1.197.00 , punimet prgaditore dhe përfundimtare - pastrimi, barshatave drujtë



mbetur dhe mbeturinave në shumën prej 300.00 € , në shumën e përgjithshme prej 15.359.40 € (Pese mbdhjetmijë e treqin pesdhetënënt €).

Gjykata pas vlersimit të ekspertizës të njëjtës i dha bindje të plotë për faktin se në mënyrë të drejt dhe objektive e ka caktuar çmimin kushtues për ndërtimin e murit mbrojtës që duhet t,i shërbej evitimit të shëmbjes së parceles së mbetur katastrale.

Vlenë të sqarohet se në ekspertizat e administruara përmendër në disa raste rruga Runik – Kosterc e që bëhet fjalë për rrugën e njëjtë e cilë e lidhë bashkësin lokale Turicec dhe Runik që kalon nëpër fshatin Kosterc.

Në bazë të fakteve të vërtetuara nga provat e administruara pa mëdyshje është vërtetuar se padija e paditësit është e bazuar dhe mbi këtë bazë paditësit sipas dispozitave materjale të cituara më lartë i është gjykata i ofroj mbrojtje gjyqësore.

Gjykata i vlerësoj kundërshtimet e palës së paditur ndaj padisë por të njëjtat nuk janë të argumentuara me fakte dhe si të tilla nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e paditur t,i bartë shpenzimet e procedurës të specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 2 , 453 paragrafi 2 i LPK së.

Me sa u tha më lartë konform dispozitave të nenit 143 të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM**

Cnr. 253/2015 të datë 05.09.2016



Gjyqtari,
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.238/17

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Islam Hoxha nga fsh. Runik, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shefqet Ibrahim avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj, që e përfaqëson me autorizim Fatos Sejdiqaj, Avokat Publik Komunal, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.253/2010, të datës 05.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.03.2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna Skenderaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.253/2010, të datës 05.09.2016, VËRTETOHET.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.253/2010, të datës 05.09.2016, ka vendosur:

Aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Islam Hoxha nga Runiku.

Detyrohet e paditura Komuna Skenderaj që paditësit t'i kompensoj dëmin material të shkaktuar me ndërtimin e rrugës Turiqec-Runik, në pjesën e parcelës kadastrale 1269-1 që i është marrë sipërfaqja e tokës prej 337 m², në ZK Runik, shumën prej 25.275,00 Euro, për dëmin për 100 trungje të drunjëve dekorativ (pisha) të dëmtuara në këtë parcelë shumën prej 1400 Euro, për

ndërtim të murit mbrojtës për evitimin e shembjes së parcelës së mbetur, në shumën prej 15.359,40 Euro.

Gjithsejt në shumën e përgjithshme prej 42.034,40 Euro (dyzet e dy mijë e tridhjetë e katër euro), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 79 Euro për hartimin e padisë, 106 Euro për taksë për padi, për aktgjykim shumën prej 50 Euro, për tri ekspertiza 450 Euro, për përfaqësimin të avokatit shumën prej 726 Euro, të gjitha këto shuma të lartshënuara duhet të paguhet në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i të paditurës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të aprovojë ankesën dhe të prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195, të LPK-së gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me dt. 05.09.2008, ka ushtruar padi më të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensojë dëmin material, për shkak se me rastin e ndërtimit të rrugës Turiqec-Runik, iu ka marrë një pjesë e truallit në Runik dhe nuk është kompensuar prona, i është shkaktuar dëmi në drunjtë dekorativ që ishin të mjellur në parcelë dhe nuk është ndërtuar muri mbrojtës për sigurimin e parcelës së mbetur nga shembja që i kanoset, ashtu që pas ekspertizave gjyqësore e ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar shumën prej 42.434,00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.253/2010, të datës 05.09.2016, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit e duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se në bazë të kontratës së lidhur në Gjykatën Komunale në Skenderaj me dt. 02.03.2010, në mes paditësit si blerës dhe Vukomir Staleta Lazovic nga Runiku, e vërtetuar me nr. 244/2010, vërtetohet se paditësi nga një punë e vlefshme juridike kishte fituar të drejtën e pronësisë në pronën e paluajtshme lëndore parcela kadastrale P-72015062-01269-1, me kulturë bujqësore në vendin e quajtur "Miftaraj-te Shtëpia", në sipërfaqe prej 475 m2, të cilën pronë e ka regjistruar në emrin e tij në regjistrin për paluajtshmëri UL-72015062-00473, e që sipas nenit 36 të LPDTS, paditësi e ka fituar pronësinë në parcelën lëndore. Nga ekspertiza e gjeodezisë e ekspertit Bedri Gashi, është vërtetuar se ngastra lëndore nr.1269-1, në formë trekëndëshi gjendet në ZK Runik, e cila kufizohet në anën verilindore dhe veriperëndimore me rrugën magjistrale Mitrovicë-Pejë, e

kufizohet me parcelën nr. 2051-0, nga pika 1,2,3 dhe 4 rrugë publike me gjatësi prej 33.4 m, e cila është objekt kontesti, ndërsa në pjesën veriperëndimore dhe jugperëndimore me rrugën Runik-Kosterc, e që parcela është me kulturë kullësë, e pjesa e mbetur është e mbjellur me drunjë dekorativ-pisha. Sipërfaqja lëndore nr. 1269-1, me sip. 475 m², nëpër të cilën është ndërtuar rrugë e asfaltuar në gjerësi prej 5.5 m dhe gjatësi 33.84 m, e cila rrugë në gjatësinë e saj ka skarpatën (pjesën e pjerrtë) nga pika 4 dhe 5 që ka lartësinë afro 2.5 m, ndërsa në pjesën fundore nga pika 1 në drejtim të pikës 6 ka lartësinë prej 5.50 m dhe një kënd pjerrtësie afro 42 shkallë, e nga kjo gjendje rezultoi se paditësit iu është marrë 337 m² nga parcela kadastrale 1269-1 me rastin e ndërtimit të rrugës Turicevc-Runik, ndërsa i ka mbetur sipërfaqja prej 138 m², nga e cila ekspertizë gjykata vërtetoi bazën e kërkesëpadisë. Lartësinë e çmimit të tokës, gjykata e vërtetoi me angazhimin e ekspertit të agronomisë inxh. Hajrullah Muli, sipas të cilit paditësit iu është marrë sipërfaqja prej 337 m² dhe i ka mbetur sipërfaqja prej 138 m², e cila nuk mund të shfrytëzohet për ndërtim të shtëpisë apo veprimtari biznesi, ngase pjesa e mbetur për shkak të pjerrtësisë ka filluar të rrëshqet dhe do të pësojë humbje të vlerës, e që duke marrë për bazë firmën e parcelës-trekëndëshit, duke marrë mendime edhe nga fqinjët lidhur me çmimet aktuale në afërsi të pronës, ka ardhur në përfundim se metri katror në këtë vend është në shumë prej 75 Euro, e që duke llogaritur sipërfaqen e marrë nga e paditura 337 m², arrijn shumën prej 25.275 Euro. Më tutje eksperti në fjalë e ka vlerësuar edhe parcelën e mbetur të paditësit ku kanë qenë të mbjellur drunjë dekorativ-pishat të llojeve: smarakt, argjenta lejlan dhe aura, ku me rastin e ndërtimit të rrugës janë dëmtuar 100 trungje, e duke u bazuar edhe në ofertat e marra nga agrodyqanet, vlerësoi se çmimi total i trungjeve të dëmtuara përfshin vlerën 1400 Euro. Lidhur me pjerrtësinë e parcelës që u deklarua eksperti i gjeodezisë që rrezikon të shembet nëse nuk ndërtohet muri mbrojtës, atëherë për caktimin e vlerës së këtij muri mbrojtës gjykata ka angazhuar ekspertin e ndërtimtarisë inxh. Bajram Mustafa, i cili sipas gjetjeve në terren ka ardhur në përfundim se domosdo duhet të ndërtohet muri mbrojtës për shkak të rrëshqitjes së dheut në rrugë dhe mund të vijë deri të zhdukja e sipërfaqes së truallit, andaj sipas ekspertit çmimi i tërësishëm për ndërtimin e murit mbrojtës kap shumën prej 15.359,40 Euro, e që në detaje e ka përshkruar në ekspertizën e tij. Gjykata ekspertizat në fjalë i vlerësoi të punuara në mënyrë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme për të vërtetuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit gjykata e shkallës së parë vendosi konform nenit 36 të LPDTS dhe 154 dhe 155 të LMD-së dhe nenin 46 par.1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 452.2 dhe 453.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta

edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadisë dhe lidhur lartësinë e saj, përkundër pretendimeve ankimore të palës ankuese, pasi që si baza, ashtu edhe lartësia e kompensimit është vendosur në mënyrë meritore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe në përputhje me provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës.

Lidhur me pretendimet e ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, nga ku gjykata iu ka falur besimin mendimit profesional të ekspertëve nga lëmi i gjeodezisë, agronomisë dhe ndërtimtarisë të cilët në ekspertizat e tyre, kanë dhënë sqarime precize dhe të mjaftueshme për të vërtetuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit. Edhe kjo gjykatë vlerëson se ekspertizat janë të punuara në mënyrë profesionale me të dhëna të qarta për çështjen konkrete, andaj Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur e ka obliguar të paditurën që t'ia kompensojë dëmin material në shumën e cekur si në dispozitivin të aktgjykimit të ankimuar, ngase me ekspertizat e ekspertëve është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike.

Gjykata e Apelit nuk e pranon pretendimin ankimor se paditësi nuk është pronar i parcelës lëndore, ngase me shikim në shkresat e lëndës, konkretisht në bazë të kontratës së lidhur në Gjykatën Komunale në Skenderaj me dt. 02.03.2010, në mes paditësit si blerës dhe Vukomir Staleta Lazovic nga Runiku e vërtetohet se paditësi nga një punë e vlefshme juridike kishte fituar të drejtën e pronësisë në pronën e paluajtshme lëndore parcelë kadastrale P-72015062-01269-1, me kulturë bujqësore në vendin e quajtur "Miftaraj-te Shtëpia", në sipërfaqe prej 475 m², të cilën pronë e ka regjistruar në emrin e tij në regjistrin për paluajtshmëri UL-72015062-00473, e që sipas nenit 36 të LPDTS, paditësi e ka fituar pronësinë në parcelën lëndore, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara.

Sa i përket pretendimit ankimor se nuk është bërë përkufizimi i ngastrës lëndore, nuk qëndron, ngase me ekspertizën e gjeodezisë në mënyrë të saktë, të përpiktë dhe të detajizuar është bërë përkufizimi i pjesës së ngastrës lëndore të marrë nga e paditura, e që është cekur edhe në

arsyetim të aktgjykimit të atakuar, e që kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret është fakt relevant për çështjen konkrete vlerësimi i lartësisë së dëmit, respektivisht lartësia e çmimit të tokës së marrë nga e paditura, e që nuk ishte kontestuese që paditësit pa kurrfarë procedure iu është marrë pjesa e pronës së paditësit, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se ekspertizat në fjalë janë të qarta dhe me sqarime të mjaftueshme për të vërtetuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit, andaj nuk i pranon pretendimet ankimore në këtë drejtim, e poashtu edhe me shikim në shkresat e lëndës kjo gjykatë ka gjetur se e paditura ka bërë përpjekje për të bërë marrëveshje me paditësin, e poashtu e ka pasur rastin që të kërkojë sqarime nga ekspertët të cilën gjë edhe e ka bërë, por në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të dt.05.09.2016; pasi që u administruan provat në mesin e të cilave edhe ekspertizat, e paditura nuk ka paraqitur vërejtje, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim janë refuzuar si të pabazuara, nga shkak se e paditura ka mundur të shfrytëzojë mundësinë nëse ka pasur vërejtje apo propozim për ndonjë ekspertizë eventuale, por të cilin veprim nuk e ka ndërmarrë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, andaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve në këtë drejtim, ngase sipas nenit 36 të LPDTS, parashihet se *"Për bartjen e pronës së paluajtshme është e nevojshme një punë e vlefshme juridike ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë, në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri"*, andaj mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit gjen se paditësi në bazë të kontratës së shitblerjes të vërtetuar në gjykatë dhe më pas i regjistruar në regjistrin e paluajtshmërive si pronar i ngastrës, me të drejtë kërkon kompensimin e dëmit material, ngase e paditura pa kurrfarë procedure ia ka marrë pjesën e pronës pa kurrfarë kompensimi, duke ia rrezikuar edhe pjesën e mbetur të saj, nëse nuk e ndërton murin mbrojtës, ku e drejta e pronës është e garantuar me Kushtetutë nenin 46 par.1 dhe 3 dhe askush nuk mund të privohet nga e drejta e pronës në mënyrë arbitrare. Meqenëse e paditura i ka shkaktuar paditësit dëm material, kompensimin e të cilit e kërkon paditësi, e meqë një gjë e tillë është vërtetuar nga ekspertizat gjyqësore, gjykata e shkallës së parë më të drejtë e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë dëmin në lartësinë e lartëkur e konform nenit 154 të LMD-së, nga çka rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, andaj pretendimet ankimore u refuzuan si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, andaj edhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i mori për bazë të gjitha pretendimet e palës ankuese, por që nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitën e nenit 452.1 dhe 453.1 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.238/17 data 09.03.2020

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca Dula d.v.



SAKTESINE E KOPJES E VERIFIKON
UDHENEQËSI I SHKRIMORES SË GJYKATËS
TAÇNOST KOPIJE POTVRDUJE
KOSOVODIGG SUDSKE PISARNICE